



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 864/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Mirushe Sadikaj për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, paraqitur kundër Ramiz Zikolli nga Istogu, Astron Dreshaj nga Istogu, Azem Berisha nga Istogu, Shaban Jahaj nga Istogu dhe Nezir Idrizaj nga Istogu, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si të pa afatshme ankesat: Anr.864/13, Anr.865/13, Anr.866/13, Anr.867/13, Anr.868/13, të datës 14.11.2013, të Mirushe Sadikaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.864/13, Anr.865/13, Anr.866/13, Anr.867/13, Anr.868/13, me datë 14.11.2013, nga Mirushe Sadikaj për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, në të cilën pretendohet se pas numërimit të votave të njejtat më mungojnë, pasi që janë edhe personat që kanë votuar për mua, por ato vota nuk janë numëruar.

- Në ankesën Anr.864/13 të datës 14.11.2013, pretendohet se votuesi Xhevdet Kabashi betohet se më ka votuar, por vota e ti nuk është numëruar.
- Në ankesën Anr.865/13 të datës 14.11.2013, pretendohet se personi Rrustem Bajrama ka votuar për mua, por që vota e tij nuk figuron, pasi që nuk është numëruar.
- Në ankesën Anr.866/13 të datës 14.11.2013 pretendohet se, votuesit Qaush Imera dhe Arton Imeraj me familje betohen se më kanë votuar, por votat e tyre nuk figurojnë.
- Në ankesën Anr.867/13 të datës 14.11.2013, pretendohet se votuesi Enver Hajra ka theksuar se ka votuar për mua, ndërsa vota e tij nuk figuron gjatë numërimit dhe konsideroj se nuk është numëruar.

- Në ankesën Anr.868/13 të datës 14.11.2013, pretendohet se votuesi Shukri Pepaj betohet se ka votuar për mua dhe gjatë numërimit është bërë me qëllim apo pa qëllim.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa afatshme

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të pa afatshme ngase ankesat në fjalë nuk janë parashtruar brenda afatit e paraparë ligjorë që është 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, ky afat ligjor ishte 04.11.2013 deri në 19:00, siç përcaktohet me nenin 119.1 të LZP-së, se për të gjitha parregullësit lidhur me ditën e votimit mund të parashtrohet ankesë në PZAP brenda afatit të sipërshënuar. Andaj ankesat nga pala e interesuar janë parashtruar në PZAP me datë 14.11.2013, nga kjo del se të gjitha ankesat në fjalë janë të pa afatshme.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP-i refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 864/2013 më datën 15.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, mund të paraqitet ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.